

K O N T R A T E

Me pjesemarrjen ne shoqerine "COMECA" s.a (qe ne poshte do te referohet si "Shoqeria" ndermjet pjesetareve te saj :

Pjesetaret rane d'kort persa vijon :

Neni 1

Shoqeria te funksionoje si ndermarrje aksioniere me pergjegjesi te kufizuar (SHPK), konform legjislacionit shqipetar. Statutit te shoqerise dha kesaj kontrate, miratuar nga aksionieret e shoqerise (ne poshte do te referohen se "Aksioniere").

Neni 2

Kapitalit i themelimit te shoqerise eshte 100.000 leke dhe eshte i ndare ne kete menyre: PIRRO GJINARI 50.000 leke dhe STOJAN ANGJELI 50.000 leke. Ky kapital do te jetet teresisht i shlyeshme dhe i nenshkrueshem nga ortaket e mesiperme.

Perqindjet e mesiperme do te percaktojnë edhe numrin e votave per sejcilin aksionier, qe numerikisht dote jete i barabarte me masen e perqindjes .

Gjithashtu keto perqindje percaktojnë edhe masen e pjesemarrjes ne fitimet e shoqerise per sejcilin aksionier.

Neni 3

Të gjitha mosmarrevashjet qe lindin ndermjet aksioniereve e qe nuk zgjidhen ne mirekuptim, do te zgjidhen nga Gjykata e rrëhit Tirane.

Neni 4

Persa nuk eshte peraktuar ne kete kontrate zgjidhja pra de te tyrimet dhe te drejtat e aksioniereve do te behet ne baze te ligjes nr.7638 date 19.11.1992 Per shoqerite tregtarë" etj.

Neni 5


Ajo kontrate, si dha statuti qe i bashkangjitet as. j perpilohen ne 4 kopje, qe mbasi nenshkuhet nga aksionieret, njera dorezohet ne organet gjyqesore per rirregjistrim dhe tre kopjet e tjera depozitohen ne ne aktet e themelimit.

ORTAKET ZHËMELUES SHOQERISE AKSIONIERE
" COMEC "

ing.PIRRO GJINARI



Ing.STOJAN ANGJELI



Tirane, ne 29.9.1993

S T A T U T

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJSI TË KUFIZUAR (SH.P.K.)

" COMEC

"

Stojan Anxheli dhe Pirro Gjinari ortakë të shoqërisë" COMEC

veç nënshkrimit të kontratës për themelimin e kësaj shoqërie, hartuan e nënshkruan edhe statutin e saj me këtë përbajtje:

KREU I

Neni 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Shoqëria me Përgjegjsi të kufizuar " COMEC "

Tiranë, në përputhje me vendimin për krijimin e shoqërisë me përgjegjesi të kufizuar" (SH.P.K) dhe në legjislacionin Shqiptar, rregullon pozitën juridike të themeluesve dhe të punonjësve në shoqëri, dhënat me rendësi për qarkullimin juridik, organizimin dhe objektin e vepmtarisë së shoqërisë dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e shoqërisë.

Neni 2

Shoqëria nga neni 1 i këtij statuti krijohet me mjete vetiake të themeluesve me karakter pronë private.

Neni 3

Shoqëria nga neni 1 dhe 2 i këtij statuti do të ushtrojë veprimtarin e saj me emërtimin " COMEC "(SH.P.K.) Tirana.

Neni 4

Shoqëria ka statusin e personit juridik.

Neni 5

Selia e shoqërisë është në Tirana Rr;"Haxhiot Gjollecha"

Fall: 43. Shk: 27, Ap: 163

Neni 6

Shoqëria ka vilen e saj. Vula ka formë të drejtëkendoshme madhësi brenda të zakonshme, përmes përgjegjës së saj është shkruar teksti shoqëria private COMEC ndërsa në mes është vendosur sigla e shoqërisë.

RGS

SG

Neni 7

Shoqëria ka për objekt dhe qëllim kryesor të veprojë në fushën e ~~treftimit te mallrave ushqimore, industriale, import -export me shumice pakice, investimeve, ndertimeve, objekteve soc. kulturore etj;~~

Neni 8

Shoqëria e ushtron veprimtarin e saj të përcaktuar në këtë statut në territorin e Republikës së Shqipërisë. Për kryerjen e kësaj veprarie shoqëria mund të çelë degë dhe zyrat e saje të përfaqsimit ne vend dhe jashtë, në përputhje me legjislationin shqipëtar dhe legjislacionin e vendit ku çelen ato.

Neni 9

Shoqëria kryen veprimtarinë e saj për të realizuar fitimin duke mbështetur në parimet e likuiditetit, sigurisë dhe rentabilitetit.

Neni 10

Pjesmarrja në shoqëri nuk i pengon ortakët të kenë pavarsi ligjore për veprimtari të tjera dhe për të drejta të tjera pronësie. Ortakët që marrin pjesë në shoqëri nu i nënshtrohen asaj si persona. Ata nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë që rrjedhin nga objekti i veprimtarisë së saj, tej kapitalit themelor ku ata kanë marrë pjesë. Po kështu as shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e ortakëve të saj.

Neni 11

Ortakët kanë këto të drejta kryesore:

- Të marrin pjesë në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me kontratën e statutin, vetë ose nëpërmjet përfaquesve të tyre
- Të marrin pjesë në rezultatet e veprimtarisë së shoqërisë ne çë formë e sasie qoftë në përputhje me kontratën e statutin.
- Të marrin pjesë në organet e shoqërisë, që janë ose mund të kriehen, nëpërmjet përfaquesve të tyre ose vetë.
- Të kërkojnë t'u jepen të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjendjen prodhuese e tregtare të shoqërisë, si dhe gjithë dokumentat e përpunuara nga shoqëria, si bilancet, llogarit ekonomike etj.

RGS

SJL

- Të bëjnë propozime dhe ti paraqesin ato për shqyrtim para organave të shoqërisë.

Neni 12

Ortakët kanë këto detyra kryesore:

- Të depozitojnë kuotën e tyre në përputhje me aktin e themelimit të shoqërisë(kontratën) dhe me këtë statut.

- Të marrin pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara prej tyre,vetë ose nëpërmjet përfaqshuesve që caktojnë ata.

- Ti jepin shoqërisë informatat e nevojshme cë kanë të bëjnë me securin e veprimtarisë së saj.

- Të kryejnë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave dhe realizimin e fonksioneve të shoqërisë.

Neni 13

Secili ortakë pjesën e vet të kapitalit themeltar mund ta transferojë në persona të tretë, që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, por vetëm me miratimin e ortakeve të tjerë. Projektvendimin për transferimin i njoftohet shoqërisë dhe secilit ortak. Në rast se shoqëria nuk ka bërë të ditur vendlimin e saj brënda tre muajve nga data e njoftimit, miratimi i transferimit konsiderohet i dhenë. Në rast se shoqëria refuzon të jepë miratimin e transferimit, secili ortak brënda tre muajve nga data e këtij refuzimi, duhet të blejë ose të lejoj blerjen e pjesve të kapitalit themeltar me vlerën e përcaktuar sipas rregullave të parashikuara në nenin 11 të ligjit " Për Shoqërit Tregtare."

KREU II

KUSHTET EKONOMIKE

Neni 14

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të parimeve të llogari dhe pasqyrohet në bilancet e sej.

Neni 15

Për të bërë të mundur zhvillimin e veprimtarisë së shoqërisë caktuhet një kapital themeltar prej 100.000 lekë nga i cili:

- Stojan Andjeli	50.000	lekë
- Pirro Gjinari	50.000	"

Ortakët marrin pjesë në krijimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me kuotat e tyre të barabarta. Afatet e derdhjeve së kapitalit themelor të shoqërisë të ndara në kuata për secilin ortak depozitohen në bankë për llo gari të shoqërisë nga administratori. Administratori u dorzon ortakëve një dokument me të cilin vertetohet derdhja e kuotave në para prej tyre.

Neni 16

Shoqëria në emër të vet është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurive të saj, por gjithmonë në përputhje me qëllimin dhe objektin e vept tarisëqë ajo kryen. Shoqëria mund të blejë pasuri ose të shfrytzoj të dreta të tjera materiale. Ajo mund të afroj për garanci edhe pasurit e saj pëtë marrë krëdi bankare.

Neni 17

Shoqëria krijon fondin rezervë, ose dhe fonde të tjera të veganta financimi, për zhvillimin e nxitjen ekonomike të saj. Shoqëria i disponon plotesisht mjetet e veta financiare. Detyrimet eventuale që mund t'ë lindi gjatë veprimtarisë së saj mbulohen nga fondi rezervë, nga fondet e tjera, ose nga shumat suplementare që kur deshirojnë mund t'ë derdhen prej ortakëve, në rastet kur këto detyrime nuk mund t'ë mbulohen nga fondet egzistuese.

Neni 18

Fitimi i realizuar nga shoqëria gjatë një viti ndahet ndermjet ortakëve në proporcione pjesët e kapitalit themelor të derdhur nga seċili ortak.

KREU III

ADMINISTRIMI

Neni 19

Organ vendimor i shoqërisë është asambleja e ortakëve, e cila ver dos me unanimitet për të gjitha çështjet që merr në shqyrtim, si për bilancin vjetor, për ndryshime në statut, për shtimin ose pakësimin e kapitalit themeltar, për emërimin e administratorve të drejtorit të përgjithshëm e shkarkimin e tyre, përcaktimin e drejtimeve kryesore të veprimtarisë së shoqërisë, si dhe për shkrirjen ose mbylljen e saj.

AGS

Neni 20

Asambleja e ortakëve mblidhet rregullisht një herë në çdo tre muaj, ditën e fundit të muajit të tretë. Me kërkesën e çdo ortaku, administratori ose të drejtorit të përgjithshëm, asamblea e ortakëve mund të mbledhet edhe jashtë rradhe.

Ortakët për mbledhjen e asamblesë dhe rendin e ditës lajmërohen të paktën 15 ditë përpëra mbledhjes me letër me shkrim.

Çdo mbledhje e thirur në mënyrë të parregullt mund të anullohet pranë ortakëve. Megjithatë anullimi i mbledhjes së asamblesë së ortakëve nuk ka vlerë, në rast se gjithë ortakët ose përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm në mbledhje.

Secili ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e asamblesë dhe të votoj për çështjet që shqyrtohen duke patur të drejtë vote të barabartë me ortakët e tjerë.

Neni 21

Në mbledhjen e asamblesë së ortakëve ose edhe në konsultimet e saj me shkrim për çështjet e caktuara vendimet merren ~~me~~ unanimitet.

Asamblea e ortakëve kur nuk siguron unanimitet në marrjen e vendimeve për çështje të rëndësishme si, për pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, për zhvillimin e operacioneve tregtare me vlerë 100.000 dollarë, ose për pushimin a zvoglimin e veprimtarisë së shoqërisë me votim me të drejtë vote të barabartë të drejtorin e përgjithshëm. Në këto raste për çështjet vendoset me shumicë votash.

Neni 22

Organ i administrativ i shoqërisë është administratori ose administratorët që zgjidhen nga asambleja e ortakëve. Administratori përfaqëson shoqërinë kundrejt të tretëve brenda caqeve të veprimtarisë së saj, si dhe kryetarët gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Kompetencat ekskluzive të administratorit të shoqërisë janë:

- Të miratojë planet e llogaritë ekonomike, pas përpunimit të tyre në kuadrin e veprimtarisë së shoqërisë.

Roj S

- Të bëjë propozimet e nevojshme në asamblenë e ortakëve për ndryshimin, kur lind nevoja e kapitalit themelor të shoqërisë.

- Të miratojë akte normative që përcaktojnë raportet në gjirin e shoqërisë ~~dike~~ përfshirë kuadrin dhe personelin.

- Të përcaktojë strukturën e aparatit të shoqërisë.

- Të krijojë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë.

- Të propozojë në asamblenë ~~e~~ ortakëve për krijimin e njesive strukture si filiale, degë e përfaqësi në qytete të tjera të vendit, ose në qëndra të banuara.

- Të përgatisë propozimin për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe tja paraqesë atë asamblesë së ortakëve për miratim.

- Të përzgjedh ekspertët kontabël dhe anëtarët e komisionit të likudimit dhe të paraqitë propozimet për miratim në asamblenë e ortakëve.

- Të sigurojë zbatimin e përpiktë të vendimeve të asamblesë së ortakëve.

-Të përcaktojë numrin e punonjësve të shoqërisë dhe pagat e tyre.

Neni 23

Veprimtaria operative e shoqërisë administrohet nga drejtori i përgjithshëm i saj, i cili përbën organin ekzekutiv.

Drejtori i përgjithshëm në kuadrin e kompetencave të tij të përcaktuara në këtë statut dhe nga vendimet e asamblesë së ortakëve, vepron në gjithë sektorët e shoqërisë për ndjekjen dhe realizimin e veprimtarisë të përcaktuar në objektin e saj.

Drejtori i përgjithshëm i shoqërisë ka këto detyra kryesore:

-Organizon dhe kontrollon punën për zbatimin e detyrave që rrjedhi nga planet ekonomike e financiare të shoqërisë.

-Ndjek zbatimin konkret të vendimeve të ~~asamblesë~~ së ortakëve dhe të administratorëve.

-Administron veprimtarinë e filialeve, përfaqësive ose degëve me prokurë ose sipas vendimit të ~~asamblesë~~ së ortakëve.

SX
-Përfaqëson shoqërinë papa të tretëve, në gjykatë, në arbitrazh ose

dhe me organe të tjera shtetërore.

-Nënshkruar kontrata në emër dhe përllogari të shoqërisë me përjash tim të atyre që lidhen prej asamblesë së ortakëve dhe administratorëve.

-Raporton para asamblesë së ortakëve dhe administratorëve dhe përgjegjjet para tyre për veprimtarinë e shoqërisë në kuadrin e kompetencave të tij.

K R E U IV

KOHË ZGJATJA E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Neni 24

Afati i veprimtarisë së shoqërisë caktohet për një periudhë prej mbi 10 vjet të njëpasnjëshme.

K R E U V

MARDHËNIET E PUNËS

Neni 25

Mardhëniet e punës në shoqëri rregullohen në përputhje me vendimi për krijimin e shoqërisë, ligjislacionin shqiptar dhe me këtë statut.

Neni 26

Punësimi i punonjësve në shoqëri bëhet mbi bazën e kontratës kohësive të punës.

Në kontratën e punës rregullohen këto çështje;

-Kushtet dhe mënyra e mardhënieve së punës.

-Fillimi i punës së punonjësve dhe caktimi i tij në vëndin e punës.

-Koha e punës dhe caktimi i kohës së punës, puna e natës, puna jashtë kohës së punës normale, puna në ditën e pushimit javor dhe festat e zyrtare.

-Mbrojtja në punë dhe kushtet e punës.

-Pushime dhe mungesat, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e punonjësve për zbatimin e detyrave të punës.

-Pushimi i mardhënieve së punës.

-Paga e punës së punonjësit, shpërblimi i punës dhe shpërblime të punësve.

K R E U VI

PËRGJEGJËSIA E PUNONJËSVE

Neni 27

Rex
Punonjësi është personalisht përgjegjës për kryerjen e punëve dhjetë zbatimin e detyrave me ndërgjegje, në mënyrë të ligjshme dhe profesional.

K R E U VII
MBYLLJA E SHOQËRISË

Neni 28

Veprimtaria e shoqërisë mbaron me afatin e përcaktuar në aktin e themelimit, ose më parë sipas propozimit të bërë nga një prej ortakëve, kur gjatë dy vjetëve të njëpasnjëshëm veprimtaria e saj rezulton jo rentabël.

Shoqëria shpërndahet në formë riorganizimi ose likujdimi.

Neni 29

Kur shoqëria likujdohet asamblea e ortakëve emron komisionin e likudimit, i cili i paraqet për miratim bilancin e likujdimit të shoqërisë. Shoqëria i jep fund veprimtarisë së saj në çastin e miratimit të bilancit të likujdimit.

Neni 30

Mjetet financiare si dhe çdo pasuri tjetër e fituar si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë, kur shoqëria likujdohet ndajen ndërmjet ortakëv në përpjestim me kuotat e tyre në kapitalin themelor, pasi të jenë bërë pagesat për kreditorët.

Neni 31

Ky statut hartohet në 4 kopje dhe firmoset rregullisht nga ortakët themeluës të shoqërisë sot me dt.

O R T A K È T

GJODAII ALBANI

TTERIO DUFARI